

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE PER AKTIVITETIN:

**“Fraksionimi i produkteve minerale jometalike
dhe prodhimi i produkteve abrazive, prodhimi i
betonit dhe asfaltobetoni”**

“Rikuperimi i mbetjeve jo te rrezikshme”

Vendodhja: Rruga nacionale Tirane – Fushe Kruje, Dritas,
Nr. pasurie 665/14, zona kadstrale 1459, Njesia Administrative
Zall Her, Bashkia Tirane.

Kërkues: Subjekti: “THURJE” Sh.p.k



Dhjetor, 2022

TABELA PERMBLEDHESE

1	HYRJE	3
1.1	TE PERGJITHSHME	3
1.2	PROCESI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS	4
1.3	KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS TË NJË PROJEKTI	4
2	PERSHKRIMI I RAJONIT KU ZHVILLOHET AKTIVITETIT	5
3	PERSHKRIMI I AKTIVITETIT	19
4	MASAT ZBUTESE TE NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS	37

1 HYRJE

1.1 Te pergjithshme

Qellimi i ketij aktiviteti eshte fraksionimi i mineralit jometalike dhe rikuperimi i mbetjeve jo te rrezikshme, kruesisht mbetje inerte te ndryshme, mbetje sterile te ndryshme per prodhimin e inerteve te cilat jane lende e pare ne industrine e ndertimit. Gjithahstu ky aktivitet ka per qellim prodhimin e betonit dhe asfaltobetonit, po ashtu per përdorim ne industrinë e ndertimit.

Aktiviteti do te zhvillohet ne krahe te rruges nacionale Tirane – Fushe Kruje, Dritas, Nr. pasurie 665/14, zona kadstrale 1459, Njesia Administrative Zall Her, Bashkia Tirane.

Subjekti “Thurje” shpk per zhvillimin e aktivitetit te tij ka ndritur gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe eshte ne fazën e instalimit te impianteve.

Subjekti “Thurje” shpk merren me veprimtari qe konsistojnë ne ransportimin, perpunim dhe riciklim te materialeve inerte, si: rera, zhavorre, gure, çakull, gelqere, granile etj, dhe materialeve te ndryshme per ndertim. Transport mallrash te te gjitha llojeve per vete dhe per te trete, personash brenda dhe jashte vendit. Shitje dhe blerje automjeteve te gjitha llojeve dhe riparimi i tyre. Sherbime gomisterie, shitje goma te madhesise te ndryshme dhe bateri. etj. Transportimin e mineraleve te ndryshme, tregti me shumice dhe pakice e mineraleve te ndryshme dhe materialeve inerte per ndertim. Prodhimi, tregtimi dhe transporti i betonit dhe asfaltobetonit

Grumbullim, transport, magazinim, ruajtje dhe riciklim/rukuperim i mbetjeve inerte jo te rrezikshme.

Nenshkrimi i nje sere konventash dhe miratimi i kuadrit ligjor per mjedisin ne funksion te tyre, detyron institucionet shteterore dhe subjektet fizike e juridike ti nenshtrohen disa procedurave vleresimi te impaktit te tyre para ndertimit dhe venies ne funksion te aktivitetit.

Raporti i permbledhjes jo-teknike eshte nje prej instrumentave parandalues dhe minimizues te ndikimit mjedisor dhe per projektin specifik, hartohet duke u bazuar ne kerkesat e zhvillimit te aktivitetit nga subjekti “Thurje” Sh.p.k.

Ky raport perfshin vleresimin, identifikimin, si dhe percaktimin e masave zbutese te ndikimit ne mjedis te aktivitetit te impiantit te prodhimit te betonit.

1.2 Procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e zhvillimit të aktivitetit. Në procesin studimor të VNM përdoret informacioni dhe të dhënat teknike ekzistuese.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis hartohet që në fazën e projektidese për zhvillimin e aktivitetit, por gjithsesi, edhe për aktivitete ekzistuese të cilat janë objekt i një leje mjedisore ose i ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Sipas kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, shteti siguron me të gjitha mjetet dhe mundësitë që ka, një mjedis të pastër dhe të sigurtë për qytetaret dhe brezat e ardhshëm.

1.3 Kërkesat e përgjithshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis të një projekti

Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit.

Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përgatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj. Vlerësimi përfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.

Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, të ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit.

2 PERSHKRIMI I RAJONIT KU ZHVILLOHET AKTIVITETIT

Aktivitetit “Fraksionimi i produkteve minerale jometalike dhe prodhimi i produkteve abrazive, prodhimi i betonit dhe asfaltobetonit” “Rikuperimi i mbetjeve jo te rrezikshme” do të zhvillohet në një sipërfaqe toke rreth 11 000 m², pergjate rruges nacionale Tirane – Fushe Kruje, Dritas, Nr. pasurie 665/14, zona kadstrale 1459, Njesia Administrative Zall Her, Bashkia Tirane.

1.1. Mjedisi biologjik

Peisazhi dhe mjedisi i zonës së projektit janë tërësisht të modifikuar, në përshtatje të urbanizimit të saj. Ndërkohë, në mjediset përreth, erozioni përbën një faktor problematik me intensitet më të lartë në zonat kodrinore përreth, ku krahas faktorëve natyrorë, është favorizuar nga aktiviteti njerëzor dhe shfrytëzimi pa kriter i inerteve nga shtretërit e lumenjve për qëllime ndërtimi sikurse edhe permbytjet nga mosfunksionimi i kanaleve drenuese

1.1.1. Flora

Zona e studimit karakterizohet nga mjedis me infrastrukture urbane, industriale dhe përfshin habitate tërësisht të modifikuara, ku janë mbjellë disa bimë dekorative. Për këtë arsye, zona ka vlerë të ulët botanike për shkak të mungesës së llojeve bimore me status të veçantë të ruajtjes në kontekstin lokal. Si rrjedhojë, numri i llojeve faunistike që strehoen apo vizitojnë atë, është tepër i ulët dhe janë të lidhur kryesisht me habitatet kufizuese më zonën të cilët përfshijnë vendbanimet përreth, djerrinat, si dhe shkurretat në krahun lindor dhe verior. Sipërfaqja e gjelbër natyrale është shumë e vogël dhe përfshin tapete bari dhe shumë pak lloje, si: Krisja (*Cynodon dactylon*), Mëllaga (*Pelargonium inquinans*, *Pelargonium acraeum*, *Pelargonium sp.*), dhe dredhëza e arës (*Convolvulus arvensis*). Lloje të tjera të kultivuara përfshijnë leandrin, tuja (*Thuja orientalis*), rrapi (*Platanus orientalis*), bliri (*Tilia cordata* Mill, *Tilia platyphyllos* Scop.), arra e egër (*Ailanthus altissima*) etj. Nga secili lloj drunor janë mbjellë disa individ për qëllime dekorative, kryesisht nëpër trotualet përgjatë rrugëve ndërlidhëse të zonës.

Pjesa tjetër e zonës së projektit është tërësisht e betonizuar dhe pa vegetacion, duke bërë që dhe diversiteti i llojeve faunistike, të jetë shumë i vogël. Megjithatë me vlerë të ulët botanike, habitatet ka rëndësi për fizionominë që i jep peisazhit urban zonës.

Zona e vlerësimit kufizohet dhe me mjedise të tjera të cilat luajnë rol të rëndësishëm në strehimin e llojeve faunistike që përdorin zonën e studimit si korridor kalimi. Ato përfshijnë:

a) Tokat djerrë përgjatë rrugëve dhe ndërtimeve urbane

Ky habitat ka shtrirje përreth zonës së studimit dhe përfshin bimësi tipike që zhvillohet në djerrinat përgjatë ndërtimit urban, si dhe anës rrugëve. Këto janë mjedise gjysmë-natyrore, të varfra në specie dhe tepër të shqetësuara nga njeriu. Llojet kryesore prezente përfshijnë: Hithrin (*Urtica dioica*), Manaferren (*Rubus ulmifolius*), Mëllagën pyjore (*Malva sylvestris*), Barin e mureve (*Parietaria officinalis*), Gjemb gomarin (*Cirsium vulgare*), Tatullën (*Datura stramonium*), Burbullakun (Portulaca oleracea), Lëpushkën (*Verbascum pulverulentum*), Lulediellin Evropian (*Heliotropium europaeum*), Barin

mijëfletësh (*Achillea millefolium*), Hithrin romak (*Urtica pilulifera*), Ballotën e zezë (*Ballota nigra*), Lule shtogun (*Sambucus ebulus*), Labotin (*Chenopodium botrys*), Kokoçelin ngjyrë qielli (*Centaurea salonitana*), Ushqerën (*Echium italicum*), etj. Ndërkohë, lloje të evidentuara në afërsi të zonës së ndërhyrjes janë dhe Rrapi (*Platanus orientalis*), Plepi (*Populus sp.*), dhe arra e egër (*Ailanthus altissima*), si dhe bukëderri (*Cyclamen hederifolium*), këlkaza (*Arum italicum*), rudithi dy-kallizor (*Brachypodium sylvaticum*), telishi (*Dactylis glomerata*), etj.

Me përfundimin e ndërtimit të akseve rrugore kryesore është bërë dhe risistemim i kanaleve kullues, përmes instalimit të tobinove dhe betonizimit të pjesshëm të basamentit të kanalit, në të cilat rrjedhin ujërat e grumbulluara nga reshjet. Vlera e bimësisë dhe e këtyre habitateve është përgjithësisht e ulët, për shkak të diversitetit të ulët të llojeve bimore dhe mungesës së specieve që konsiderohen të jenë të rralla kontekstin lokal ose kombëtar. Hortikultura është pak e zhvilluar, si pjesë e kopshteve të objekteve private në lagjet e vjetra ose infomale të zonës, dhe përfaqësohet nga llojet si ulliri, fiku, agrumet, hurma dhe hardhi rrushi.

1.1.2. Fauna

Ndërhyrjet në habitatin natyror dhe transformimi i saj në sipërfaqe urbane ka bërë që zona në vlerësim të përfaqësohet nga numër i vogël llojesh dhe popullata me desnitet të ulët të tyre. Kështu, përta i përket grupit të reptilëve dhe amfibëve, në këtë zonë vlerësohen të pranishëm llojet si: hardhuca e murit (*P. muralis*), hardhuca e barit (*P. taurica*), breshka e zakonshme (*T. hermani*). Këto lloje frekuentojnë dhe habitatet kufizuese të tokave të hapura me bar, shkurretat, si dhe vendbanimet përreth. Ndërkohë, të zakonshëm pranë habitateve ujore sezonale dhe rrjedhjet ujore të përkohëshme janë dhe disa lloje amfibësh, si: bretkosa e zakonshme e gjelbër (*P. kurtmuelleri*) dhe thithlopa e zakonshme (*B. bufo*). Këto lloje preferojnë me tepër habitatin e sipërfaqeve të kultivuara, në afërsi të rrjedhjeve ujore.

Si shpendë më karakteristike të kësaj zone do të përmendnim llojet e zakonshme ku përfshihen dallëndyshja bishtgërshërë, dallëndyshja bishtbardhë, dhe ajo kërbishtkuqe, bishttundësi i bardhë, harabeli i shtëpisë, gushkuqi, dervishi, kërpngrënësi, mizakapësi i përhimtë, kukuvajka, kumuria, gala, laraska, turtulli, pupeza, skifteri kthetrazi, qyqja, etj. Pjesa më e madhe e tyre është e lidhur me vendbanimet përreth.

Mammalofauna përfaqësohet nga disa lloje brejtësish të vegjël (*Rattus rattus*, *Rattus norvegicus*, *Mus musculus*). Lloje të tilla kanë si dietë ushqimet e magazinuara, mbeturinat, frutat, vemjet, etj. Si rrjedhim, ata kanë aftësi të lartë përshtatëse pranë qëndrave të banuara. Ndërkohë, gjatë natës apo në kohë të zymtë, në qëndrat e banuar në afërsi, mund të haset dhe pipstrelli i zakonshëm (*Pipistrellus pipistrellus*) dhe lakuriq të tjerë të natës, që ushqehen me insekte dhe janë të lidhur me vendbanimet.

1.2. Identifikimi i Zonave të Mbrojtura

Zonat e Mbrojtura bashkë me Monumentet e Natyrës përfaqësojnë një rrjet sipërfaqesh që mbrohen në shkallë të caktuar, sipas përcaktimeve kategorike të tyre, për shkak të vlerave natyrore kombëtare, por

edhe rajonale e globale. Referuar versionit më të fundit të Hartës së rrjetit të ZM të publikuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit¹, zona në të cilën gjendet objekti nuk ndërpret asnjë Zonë të Mbrojtur ose Monument Natyre.

Përveç statusit të zonave të mbrojtura të cilat paraqiten në hartë, Zonë e mbrojtur mund të jenë edhe objekte të veçanta me status “Monument Natyror” të cilat për rajonin në vlerësim sipas Ligjit në fuqi janë si më poshtë:

Table 1 - Monumentet e Natyrës të rrethit Tiranë			
1	Bokerimat e Mustafa Kocaj	8	Gryka e Murdarit
2	Shpella e Shutrese	9	Shkalla e Tujanit
3	Shpella e Zezë (Pëllumbasit)	10	Bokerimat e Mnerit
4	Shpella e Valit	11	Rrapi i Priskës
5	Tarraca detare e Dajtit	12	Rrapi i Kranes-Dajt
6	Kastri i Malit me Gropa	13	Rrapi i Ndroqit
7	Gryka e Skoranës	14	Arra e Babë Myslymit

Siç duket qartë edhe në ortofoton e mësipërme sipërfaqja në të cilën do zbatohet projekti për ndërtimin e objektit “2 Ndertesa industriale 3 kat me nje kat nentoke me mur rrethues dhe objekt egzistues ” nuk cënon monumentet e kulturës, zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës por as monument arkitekture . Aktiviteti ynë ndodhet në zonë industriale, dhe ka distance te konsiderueshme nga monumentet e kultures dhe zonat e mbrojtura.

1.3. Mjedisi fizik

Bashkia e re e Tiranës kufizohet në veri me bashkitë Vorë, Kamëz dhe Krujë, në verilindje me bashkinë Klos, në lindje me bashkitë Bulqizë dhe Librazhd, në jug me bashkitë Elbasan dhe Peqin dhe në perëndim me bashkitë Rrogozhinë, Kavajë, Durrës dhe Shijak.

Kjo bashki përbëhet nga 25 njësi administrative, të cilat janë: 11 lagjet e qytetit të Tiranës, Petrela, Farka, Dajti, Zall-Bastari, Bërzhita, Krraba, Baldushku, Shëngjergji, Vaqarri, Kashari, Peza, Ndroqi dhe Zall Herri. Të gjitha njësitë e bashkisë së re Tiranë janë pjesë e rrethit Tiranë dhe qarkut Tiranë, me përjashtim të qytetit të Tiranës, i cili historikisht ka qenë rreth më vete. Në territorin e kësaj bashkie ka dy qytete dhe 135 fshatra.

Zona e projektit ndodhet rreth 7 k m nga qendra e qytetit dhe kufizohet nga rrugët: Ne Veri me rrugen Industriale në jug nga Autostrada Tirane Durrës , prone private Kantier prodhim betoni dhe në lindje nga Rrugen Industriale .Kjo zone i perket Njesise Administrative Kashar , Njesia Strukturore KA/82.

Mjedisi Socio-ekonomik

¹Burimi: <http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Biodiversiteti/RrjetiiZMDBZMMaj2016.pdf>;

Qyteti i Tiranës është zemra ekonomike e Shqipërisë, me përqendrimin e numrit më të madh të bizneseve në shkallë vendi si dhe me zhvillimin e industrisë së lehtë. Fuqia ekonomike e Tiranës dallohet te sasia shumë më e lartë e kursimeve dhe e kreditit në rang kombëtar, te të ardhurat tatimore, të cilat në masë dërrmuese realizohen në Tiranë si dhe te zhvillimi i sektorit të ndërtimit.

Ish Komuna e Kasharit, e cila përfshihet në territorin e bashkisë së re konsiderohet zona më e industrializuar e vendit, si pasojë e përqendrimit të bizneseve dhe industrisë përgjatë autostradës Tiranë-Durrës.

Tirana rezulton bashkia me normën më të lartë të urbanizimit për kilometër katror, pas bashkisë së Durrësit.

Zonat bujqësore të Tiranës janë përqendruar në shkallë të gjerë te blegtoria dhe prodhimet e qumështit, por edhe tek agroturizmi. Zonat kodrinore rreth Tiranës kanë gjithashtu traditë ullirin dhe drurët frutorë.

Të territorin e Tiranës gjenden disa vendburime qymyrguri të pashfrytëzuara, ndërsa aktiviteti më i përhapur sa i përket shfrytëzimit të burimeve natyrore është përpunimi i gurit për ndërtim dhe atij dekorativ.

Gjeologjia

Tirana është Bashkia më e madhe në vend si për nga popullsia, ashtu edhe nga territori. Ajo shtrihet në tri zona gjeografike të veçanta; zona bujqësore në veri, perëndim dhe jug, zona urbane e Tiranës dhe e katër komunave rrethuese, pjesërisht të urbanizuara si dhe zona e thyer malore në lindje.

Rajoni në të cilin gjendet zona e propozuar për zhvillimin e projektit bën pjesë në zonën tektonike të Krujës dhe brenda saj, në vargun e strukturave antiklinale Krujë – Dajt – gryka e Erzenit, që vazhdon edhe më në jug duke formuar krahun lindor të tyre, i cili bie drejt lindjes me kënde 30 deri 35 gradë.

Në ndërtimin litologjik të rajonit marrin pjesë depozitimet e pjesës së poshtme që përfaqësohet nga një vazhdimësi karbonatike dhe ato të pjesës së sipërme të përfaqësuara nga materiale copëzore, terrigjene dhe shtresa e pako flishore e flishoidale. Si kufi ndarës ndërmjet këtyre dy lloj formacionesh është pako mergelore kalimtare. Mbi pakon mergelore kalimtare vendoset prerja flishoro-flishoidale që ndërtohet nga një vazhdimësi shtresash terrigjene e copëzore të cilat poshtë kanë karakter flishor kurse më lart kanë karakter flishoidal.

Zona e ndërtimit vendoset mbi depozitimet e Tortonianit përfaqësuar nga mollase, argjila, alevrolite, ranorë, me shtresa dhe reshpe qymyrore.

Tektonika

Karakteristike për rajonin në studim janë lëvizjet neotektonike ngritëse, intensiteti i ulët i të cilave përbën shkakun kryesor të relievit kodrinor.

Gjeomorfologjia

E gjithë zona karakterizohet nga reliev fushoro-kodrinor, ku bie në sy shkalla e lartë e copëtimit horizontal, shkalla e vogël deri në të mesme e copëtimit vertikal dhe pjerrësia mesatare e shpateve. Drejtimi kryesor i vargjeve kodrinorë është juglindje-veriperëndim.

Forma karakteristike e relievit që shfaqet në rajon është ajo strukturoro-erozive, që përfaqësohet nga kreshtat monoklinale dhe kuestet.

Hidrografia

Tirana është një zonë e pasur me burime ujore, pasi përshkohet nga lumenjtë Erzen, Lumi i Tiranës dhe Lumi Tërkuzë. Në territorin e saj ndodhen edhe një numër i konsiderueshëm liqenesh artificiale, të ndërtuara si në zonat malore, ashtu edhe në ultësi. Në territorin e bashkisë së re gjendet edhe Parku Kombëtar i Dajtit.

Të gjithë përrrenjtë e zonave të afërta që derdhen në to, dallohen për regjim të çrregullt të rrjedhjes, që lidhet me karakterin e regjimit të reshjeve, me veçoritë topografike të pellgut ujëmbledhës, me përbërjen prej formacionesh terrigjene të papërshkueshëm, etj.

Ata kanë karakterin e përrrenjve me rrjedhje të përkohshme, që shpesh marrin formën e rrjedhjeve baltore. Karakteri i përkohshëm i bën ata tepër të rrezikshëm, pasi për shkak të efektit eroziv zhdukin me shpejtësi bimësinë dhe mbulesën e tokave, duke e degraduar atë vazhdimisht deri në dezertifikimin e plotë të saj.

Sa i takon ujërave nëntokësorë, në zonën në studim ata gjenden në thellësi më të mëdha se 20 m. Mineralizimi i ujërave pritët të jetë i tipit hidrokarbonat magnezial i përdorshëm për t'u pirë, me vlerë maksimale të pH 5.8-7.2.


Tokat

Karakteristike për zonën ku propozohet të realizohet ndërtimi i objektit "2 Ndertesa industriale 3 kat me nje kat nentoke me mur rrethues dhe objekt egzistues", me destinacion industrial, janë Tokat e Hinjta Kafe, formimi i të cilave kushtëzohet nga klima mesdhetare kodrinore që karakterizon zonën dhe shkëmbinj të terrigjenë që e përbëjnë atë. Karakteristikë e përgjithshme e këtyre tokave është ngjyra e hinjtë kafe, përbërja mekanike më e rëndë në horizontin B, reaksioni neutral dhe lehtësisht bazik. Këto janë toka minerale, me shkallë të ndryshme të diferencimit të profilit dhe prirje argjilizimi në shtresën e mesme të tij. Formula e profilit të tokave të hinjta kafe është A1-A2-AB-BC-C ose A-AC-C. Ato kanë përmbajtje mesatare humusi dhe azoti në horizontin A, të varfëra me P, të pasura me K dhe CaCO₃, si dhe të saturuara me baza. Këto toka kanë përgjithësisht cilësi dhe strukturë fizike të mirë për shkak të përmbajtjes së humusit, CaCO₃ dhe bazave në kompleksin thithës.

Klima

Rajoni në studim përfshihet në zonën e klimës mesdhetare kodrinore e cila karakterizohet nga dimri i butë dhe tepër i lagët dhe vera e nxehtë dhe tepër e thatë, më konkretisht në nënzonën mesdhetare kodrinore qendrore. Veçoritë klimatike të zonës janë kushtëzuar kryesisht nga afërsia dhe hapja e saj në drejtim të detit Adriatik, por edhe nga lartësia e vogël e relievit dhe ngritja graduale e tij nga perëndimi në lindje.

Temperatura e ajrit merr vlera që ndryshojnë nga sektorët e ulët në sektorët e lartë si dhe gjatë stinëve të vitit. Temperatura mesatare vjetore është 15-16^oC. Temperatura mesatare e janarit, i cili është muaji më i ftohtë, luhetet në vlerat nga 4 në 6^oC, ndërsa temperaturat e korrikut luhaten ndërmjet vlerave 24-25^oC. Vlerat skajore të temperaturës luhaten në kufij mjaft të mëdhenj, nga -3.5^oC që është minimumi absolut, në 38^oC. Në rajonin në studim takohen rreth 260 ditë me temperaturë të barabartë apo më të lartë se 10^oC; 140 ditë me temperaturë të barabartë apo më të lartë se 15^oC; dhe 114 ditë me temperaturë të barabartë apo më të lartë se 20^oC. Në periudhën dhjetor-shkurt mund të shfaqen ngricat, që zakonisht zgjatin pak, rrallëherë gjatë gjithë ditës. Zona dallohet për vlera të larta të diellzimit: shuma vjetore e orëve me ndriçim diellor është 2600 orë. Në janar kjo shumë mbërrin në 125 orë, ndërsa në korrik rreth 350 orë.



Burimi BBC Weather Service

Reshjet

Reshjet përqëndrohen kryesisht në gjysmën e ftohtë të vitit gjatë së cilës bie rreth 68% e sasisë vjetore, ndërsa 32% bien në stinën e ngrohtë. Nga të dhënat e Institutit të Hidrometeorologjisë rezulton se sasia mesatare vjetore e reshjeve ndryshon nga 1241 mm në 1354 mm, e cila është më e vogël se mesatarja e gjithë vendit. Çdo vit takohen mesatarisht 120-130 ditë me reshje, shpërndarja vjetore e të cilave është e çrregullt, tipike kjo për regjimin mesdhetar. Muaji më i thatë është korriku, gjatë të cilit bien 33 mm reshje që përbëjnë vetëm 2,4 % të sasisë vjetore, ndërsa muaji më i lagësht është nëntori me 14% të reshjeve vjetore. Reshjet në formën e borës janë të rralla dhe trashësia e saj është e vogël, vetëm disa centimetra.

Era

Regjimi i erës lidhet ngushtë me relievin dhe afërsinë me detin. Drejtimet e erërave gjatë vitit janë mjaft të ndryshme, megjithatë mbizotërojnë erërat lindore dhe juglindore.

1.4. Cilësia e ajrit, e zhurmave dhe e burimeve ujore në zonën e zbatimit të projektit.


Për zonën e Tiranës janë publikuar disa të dhëna të monitorimit të cilësisë së mjedisit nga raporti vjetor i monitorimit të mjedisit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Më poshtë po ju paraqesim rezultatet e monitorimit të ajrit dhe zhurmave për qytetin e Tiranës të monitoruara nga Ministria e Mjedisit të kryera gjatë vitit 2019. Për realizimin e procesit të monitorimit janë zbatuar metodat standarte, sipas të cilave përcaktohen mesataret kohore të monitorimit të cilësisë së ajrit, bazuar në direktiven CAFÉ të BE për një ajër të pastër dhe kërkesave të EEA për raportimet.

Monitorimit të cilësisë së ajrit për vitin 2019, në Tirana, është realizuar nga Agjencia Kombetare e Mjedisit për indikatorët kryesorë të cilësisë së ajrit, si: CO, SO₂, NO_x, O₃, dhe Benzeni (µg/ m³).

Të dhënat e NO2

Monitorimi i NO2 per vitin 2019 eshte realizur ne 6 stacione si Tirane, Durres , Elbasan. Korce. Shkoder dhe ne Vlore. Bazuar ne vlerat mesatare mujore te NO2 kemi tejkallim vetem ne stacionin Elbasani per muajin Janar 2019 ku vlera e monitoruar eshte $41.61 \mu\text{g}/\text{m}^3$ nga $40 \mu\text{g}/\text{m}^3$ qe eshte norma vjetore e e NO2. Ndersa referuar vlerave mesatare per periudhen e monitorimit verezime se nuk kemi tejkallim ne asnje nga stacionet e monitoruara.

Vlerat mujore dhe mesatare te NO₂




Ne stacionin e Tiranës vlerat dy mujore jane $7.32 \mu\text{g}/\text{m}^3$ dhe $37.85 \mu\text{g}/\text{m}^3$.

Të dhënat e SO₂

Persa l perket SO2 te dhenat e monitoruara jane shume te uleta krahasuar me normen e SO2 . te dhenat jane shume te pakta . analizoret e SO2 ne te gjitha stacionet kane patur problem per shkak te mosmirmbajtjes se pajisjeve per vitin 2019.


Vlerat mujore dhe mesatare te SO₂



Të dhënat e O₃

Monitorimi i O₃ është realizuar në të gjitha stacionet por në stacionin e Durrësit vlerat kanë qenë shumë të ulëta dhe janë konsideruar të pavlefshme. Nga analizimi i të dhënave të monitoruara, siç duket dhe nga grafi ku, vërejmë se vlerat më të larta të O₃ janë monitoruar në stacionet e Korçes Shkodrës dhe Vlores ku mesataret për periudhën e monitorimit janë 64 µg/m³ në stacionin e Korçes, 78.3 µg/m³ në stacionin e Shkodrës dhe 711 µg/m³ në stacionin e Vlores. Vlerat më të larta janë monitoruar në stinën e verës ku temperaturat dhe rrezatimi diellor kanë vlerat më të larta të vitit.


Vlerat mujore dhe mesatare të O₃



Të dhënat e CO

Monitorimi i CO për vitin 2019 është realizuar në 6 stacione. Në stacionin e Tiranës 3 muaj. Vlerat më të larta janë regjistruar në stacionet e Korçes dhe Shkodrës por pa tejkaluar normën 8 orë të përcaktuar në legjislacionin Shqiptar dhe direktivave Europiane për ajrin urban.

Vlerat mujore dhe mesatare të CO



Referuar vlerave 8 orare, krahasuar me normen 8 orare qe eshte 10 mg/m³,verejme se ne asnje stacion nuk kemi tejkalim normes se CO

Zhurmat


Monitorimi i zhurmave urbane është kryer për një kohë matje 24 orëshe dhe niveli ekuivalent i presionit akustik LAeq ditën u llogarit nga ora 06⁰⁰- 23⁰⁰ dhe LAeq për periudhën e natës nga ora 23⁰⁰- 06⁰⁰. Matjet e zhurmave bëhen në mungesë të reshjeve, mjegullës dhe borës, shpejtësia e erës nuk duhet të jete më e lartë se 5 m/s, mikrofoni i mbrojtur me kufje anti-erë. Zinxhiri i matjeve duhet të jete në përputhje me kushtet meteorologjike të periudhës në të cilën bëhen matjet dhe në përputhje me normat e CEI 29-10 dhe EN 60804/1994.

Zhurme mjedisore" është çdo tingull, i padëshiruar apo i dëmshëm, i lëshuar nga veprimtaritë njerëzore,përfshirë zhurmën e lëshuar nga mjetet e transportit, nga trafiku rrugor, hekurudhor, ajror dhe nga sheshet ku zhvillohen veprimtari industriale,etj. Gjenerimi I zhurmave ka efekte negative në shëndetin e njeriut si dhe në mjedis dhe per kete duhen marre masa mbrojtese per zvogelimin e nivlit te zhurmave ne mjedis nepemjet ndërhyrjeve dhe të veprimeve, që merren ndaj burimit të zhurmës, si dhe në vendin e ndikimit të saj negativ, duke e sjellë atë në nivelin kufi . Në vendin tonë shkaktari kryesor i emetimit të zhurmave është trafiku rrugor. Kjo sepse në vendin tonë sistemi hekuridhor pothuajse nuk ekziston,ndërsa përta i përket sistemit ajror në kemi vetëm një aeroport ndërkombëtar .Gjithashtu dhe lokalet gjenerojne zhurma si ditën ashtu dhe naten.

Vlera mesatare e nivelit të zhurmave të qyteteve të monitoruara, Ditën dhe Naten.

	Laeq Ditën	Laeq natën
Tirana	67.15	57.49


Niveli I zhurmave ditën ne qytetet te monitoruara ,viti 2019



Monitorimi I zhurmave ditën kryhet nga ora 06 00 deri në orën 23 00 ku me të dhënat e monitoruara në këtë periudhë llogariten Laeq ditën për çdo stacion dhe laeq ditën për qytetet e monitoruara. Bazuar në të dhënat e monitorimit të zhurmave ditën për vitin 2019, siç duket dhe nga grafiku i mësipërm vërejmë se kemi tejkalimin të normës ditën (që është 55 dB) në të gjitha qytetet. Niveli më i lartë i zhurmave është në stacionet e Tiranës ku kemi tejkalim të normës 21.25%.

Trafiku rrugor është një fenomen i karakterit të rastësishëm, për këtë arsye themi që ndikimi i trafikut ose i çdo faktori tjetër të jashtëm që shkakton zhurmë në momentin e monitorimit mund të jetë shkaktar i uljes apo rritjes së nivelit të zhurmave urbanë në qytetet që monitorohen.

Grafiku. Niveli I zhurmave natën në qytetet e monitoruara, e vitit 2019.




Bazuar në të dhënat e monitorimit të zhurmave ditën për vitin 2019, siç duket dhe nga grafiku i mësipërm vërejmë se kemi tejkalimin të normës ditën (që është 55 dB) në të gjitha qytetet. Niveli më i lartë i zhurmave është në stacionet e Tiranës ku kemi tejkalim të normës 22%.

Trafi ku rrugor është një fenomen i karakterit të rastësishëm ,për këtë arsye themi që ndikimi i trafiku ose i cdo faktori tjetër të jashtëm që shkakton zhurmë në momentin e monitorimit mund të jetë shkaktonari uljes apo rritjes së nivelit të zhurmave urbanë në qytetet që ne monitorojmë.

Monitorimi i zhurmave naten kryhet nga ora 23 00 deri ne oren 06 00 ku me te dhenat e monitoruara ne kete periudhe llogariten Laeq naten per cdo stacion dhe Laeq naten per qytetet e monitoruara Bazuar ne te dhenat e monitoruara naten sic duket dhe nga grafiku i mësipërm vërejmë së tejkalinim më të lartë të normes naten (qe eshte 45 dB) kemi ne te gjitha qytetet .Niveli me i larte eshte monitoruar ne stacionet Tiranes me 28%.


Monitorimi i zhurmave në qytetin e Tiranes për vitin 2019 Monitorimi i zhurmave ne Tirane per 6 mujorin e pare te vitit 2019 eshte realizuar ne 15 stacione si me poshte .

Niveli i zhurmave ne stacionet e Tiranes




Referuar te dhenave te monitoruara ne 15 stacionet e Tiranes , ne te gjitha stacionet kemi tejkalinim te normes dite dhe te normes naten .Nivelet me te larta jane monitoruar ne stacionin Partizani i panjohur


ku vlera e monitoruar eshte 72.12dB dhe me e uleta ne stacionin Farmacia 10 ku vlera e monitoruar eshte 60.71dB .E shprehur ne perqindje kemi tejkalinim te normes me 31% tek Partizani i panjohur dhe 10% tek Farmacia 10. E njejte eshte situata dhe per monitorimin e zhurmave naten ku niveli me i larte eshte monitoruar ne stacionin e Laprakes ku kemi tejkalinim te mormes naten me 40% dhe me e uleta tek Selvia me tejkalinim te normes 12%.



Harta Tektonike e Shqipërisë



Harta Sizmike e Shqiperise



Harta Gjeoteknike e Shqipërisë

3 PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

3.1 Subjekti investitor

Subjekti zhvillues i keti aktiviteti eshte subjekti “Thurje” Sh.p.k me nuis M11327009B dhe me seli ne Tirane, Tirane, TIRANE, Rruga Bilal Golemi, Nr Pasurie 8/966/ND + 1 - N5-ND, ZVRPP 8270 me administrator Z. Esat Demir.



3.2 Vendodhja e aktivitetit

Aktiviteti “Fraksionimi i produkteve minerale jometalike dhe prodhimi i produkteve abrazive, prodhimi i betonit dhe asfaltobetonit” “Rikuperimi i mbetjeve jo te rrezikshme”, që kërkohet për pajisje me leje mjedisore nga shoqëria: “Thurje”, Sh.p.k, ndodhet ne krahe te rruges Rruga nacionale Tirane – Fushe Kruje, Dritas, Nr. pasurie 665/14, zona kadstrale 1459, Njesia Administrative Zall Her, Bashkia Tirane.

Zona bën pjesë në terren fushor, i ndërthurur ndërmjet pjesës fushore kodrinore. Zona përshkohet me rrugë të kategorisë së parë që lidhin zonen e aktivitetit me qytetin bashkite Kamez, Tirane si edhe me Diurresin, por edhe me zona te tjera.



Nga ana morfologjike, relievi paraqitet fushor – kodrinor dhe pak i aksidentuar. Pothuajse tërësisht sipërfaqja e zonës është e pa pyllëzuar me përjashtim të disa mbulesave vegetative të degraduara me bimësi, kryesisht shkure të ulëta dhe barishte të cilat në muajt e verës thahen.

Sheshi ku do të instalohen impiantit është i niveluar dhe si bazament për linjen teknologjike shërbejnë pilotat të nguluara në tokë, ku dhe do të montohen linjat teknologjike/impianetet, pjesa ku është ndertuar kulla e vrojtimit dhe paneli i kontrollit është e shtuar me beton, gjithashtu është ndertuar një murë mbajtës prej betoni i cili shërben për shkarkimin e lëndës së parë që vjen nga subjektet e licencuara, pjesa tjetër e sheshit ku zhvillohet veprimtaria është e shtuar me çakull dhe e niveluar, gjithashtu është ndertuar rrjeti i drenazhimit të ujrave të shiut dhe ujrave teknologjike të gjeneruara nga vete impianti.

Objekti ka një sipërfaqe relativisht të mjaftueshme të përbërë nga impiantet dhe hapësirat e nevojshme për këto aktivitete duke shfrytëzuar të gjitha ambientet për këto aktivitete. Sipërfaqja ku do të instalohen impiantet është 11 000 m² dhe është marrë me qera nga subjekti Thurje shpk.

Administrativisht sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti përfshihet në territorin e Bashkisë Tirane.



Koordinatat e sipërfaqes se ushtrimit te aktivitetit		
Nr.	X	Y
1	4395580.2	4586426.4
2	4395671	4586457.8
3	4395728.5	4586362.7
4	4395646.4	4586319.9

3.3 Infrastruktura

Zona ku do te zhvillohet aktiviteti “Fraksionimi i produkteve minerale jometalike dhe prodhimi i produkteve abrazive, prodhimi i betonit dhe asfaltbetoni” “Rikuperimi i mbetjeve jo te rrezikshme” shtrihet ne krahe te rruges Rruga nacionale Tirane – Fushe Kruje, Dritas, Nr. pasurie 665/14, zona kadstrale 1459, Njesia Administrative Zall Her, Bashkia Tirane, e cila sherben per aksesimin e drejtperdrejt te aktivitetit. Gjithashtu per ushtrimin e aktivitetit subjekti perdore rruget ekzistuese hyrese dhe dalese nga siperfaqja e ushtrimit te aktivitetit. Per mirefunksionimin e aktivitetit subjekti Thurje shpk ka ngritur gjithe infrastrukturen e nevojshme.

Furnizimi me energji elektrike kryhet nga rrjeti i shperndarjes dhe furnizimit me energji elektrike te zones ku ushtrohet aktiviteti, ku subjekti ka kontrate me OSHEE. Furnizimi me uje kryhet nga rrjeti ekzistues i furnizimit me uje te zones, ku subjekti ka kontrate me Ujesjelles – Kanalizime Kamez.

3.4 Impianti i fraksionimit dhe prodhimit produkteve abrazive

Ndertimi i Impiantit:

1. Bunkier me ushqyes vibrator $V= 50m^3$
2. Transportier kryesor $B=800mm$. $L=11m$.
3. Mulli Primar OMT MP11/12
4. Mulli Konik 800 RT Kripa
5. Mulli Centrifugal CF105
6. Transportier Mulli Primar-Site $B=1000mm$. $L=17m$.
7. Site Vibruese (5000*2000)mm.
8. Transportier rikthimi Site-Mulli Centrifugal $B=600mm$. $L=12m$.
9. Transportier rikthimi Site-Mulli Konik $B=600mm$. $L=12m$.
10. Transportier rikthimi pas thyerjes se mullirit konik $B=600mm$. $L=12m$.
11. Transportier rikthimi pas thyerjes se mullirit centrifugal $B=600mm$. $L=12m$.
12. Transportier $B=800mm$. $L=24m$.

Pedane e Furnizimit me lende te pare

Pedana sherben per mbushjen e Bunkerit Ushqyes me lende te pare. Pedana eshte projektuar me mure mbajttese prej betoni, eshte mbushur me materiale inerte dhe eshte vendi ku makinat e shkarkimit kolojne me qellim furnizimin e impiantit me lende te pare. Lartesia e perdanes eshte 4 m mbi nivelin e tokes dhe ka nje pjerrresi prej 35 grad e cila ndihmon ne ngjitjen dhe zbritjen e mjeteve te transportit. Vete impianti i fraksionimit eshte projektuar i tille qe te ndihmoje dhe te jete sa me eficient ne fraksionimin e mineralit. Ai vjen ne formen e shkalleve, ku pika me e larte eshte ajo e bunkerit ushqyes.

Bunker Ushqyes

Bunkerit ushqyes mund te quhet dhe hapi i pare qe ndodh ne procesin e furnizimit te impiantit me lende te pare. Ky bunker ka nje kapacitet prej 50 m³ dhe eshte i mjaftueshem per furnizimin e impiantit me lende te pare per 1 ore. Bunkerit furnizohet here pas here me lende te pare nepermjet pedanes se furnizimit, ku mjetet shkarkojne lende e pare te destinuar per fraksionim dhe prodhim te produkteve abrazive. Bunkerit ushqyes lidhet me pjesn tjeter te impiantit nepermjet transportierit kryesor. Bunkerit ka formen e nje hinke ne fund, e cila nepermjet vibrimeve te lehta dhe transportierit me rrula furnizon frontojen, gurethyesin me nofulla.

Mulliri Primar

Mulliri primar eshte i instaluar ne vazhdimesi te bunkerit ushqyes. Inertet me madhesi kokrrize me te madhe, nepermjet forces se rendeses dhe me gravitet kalojne ne mullirin primar i cili ben procesin e thyerjes dhe seleksionimit te lendes se pare, sipas kerkesave te tregut konsumator. Ky process teknologjik realizohet me qellim rritjen e rendimentit te instalimit dhe permbushjen sa me efektive te kerkesave te produktit perfundimtar.

Site vibruese

Sita vibruese furnizohet nga bunkeri ushqyes nepermjet transportieri kryesore, lenda e pare kalon ne siten vibruese, Lenda e pare fillimisht kalon ne katin e pare te sites, ku kryhet procesi i ndarjes se sterileve sipas granulometrise se tyre (madhesia e kokrrizes). Procesi kryesor i sites eshte ndarja e reres natyrale nga permbajtja qe ka lenda e pare. Ne katin e dyte te sites vibruese depozitohet rera natyrale e papaster, e cila ne permbatje te saj ka edhe % te dheut, ashtu sikurse ka ardhur. Pastaj lendet e para te ndara sipas granulometrise perkatese kalojne ne proceset e tjera te impiantit.

Mulliri Konik

Pas procesit te sites vibruese me dy kate, lenda e pare me madhesi kokrrize me te madhe kalon ne Mullirin konik. Madhesia e kokrrizave varion ne varesi te lendes se pare. Qellimi i kesaj makinerie eshte thyerja e kokrrizave me madhesi me te madhe dhe perftimin e kokrrizave me diameter me te vogel. Procesi qe ndodh eshte ai i therrmimit te lendes se pare nepermjet nollave, duke e bluar ate ne kokrriza me te vogla dhe dergimin e tyre nepermjet transportierit me gjatesi linear me qellim qe ti nenshtrohet proceseve te tjera.

Mulliri centrifugal

Mulliri centrifugal eshte i instaluar ne vazhdimesi te impiantit te fraksionimit. Nepermjet ketij procesi perftohet produkti i Granilit Nr.2. Sasia e produktit i cili nuk arrin te fraksionohet sipas kerkeses kalon edhe nje here ne procesin e sites vibruese nepermjet transportierit te mullirit centrifugal dhe transportierit kryesor. Ky proces teknologjik realizohet me qellim rritjen e rendimentit te instalimit dhe permbushjen sa me efektive te kerkesave te produktit perfundimtar.

Site vibruese

Sita vibruese, ben te mundur ndarjen ne tre produkte kryesore, duke ju afruar fazes perfundimtare te produktit perfundimtar. Vibrimet e lehta qe i behen lendes se fraksionuar deri ne kete proces, ben te mundur ndarjen e saj ne tre paraprodukte:

- Granil 1
- Granil 2
- Rere e thyer

Transportiet

Transportieret ne kete linje teknologjike sherbejne per transportin e lendes se pare nga bunieri ushqes drejt hapave te tjetere te procesit si Mulliri primar, konik, apo centrifugal, si edhe per transportin e produkteve perfundimtare sipas madhesis se grimces ne sheshet perkatese.

Pulti i Komandimit

Pulti i komandimit eshte pika me e larte e impiantit te fraksionimit dhe prodhimit te produkteve abrazive te destinuara ne industrine e ndertimit apo edhe per perdorim nga vete subjekti per prodhimin e betonit dhe asfaltobetonit te markave te ndryshme. Nga kjo pike vihen re te gjitha instalimet, duke mbarvajtur dhe proceset fizike qe ndodhin ne impiant. Ne kete pike jane te instaluara te

gjitha aparaturat automatike qe kontrollojne te gjitha proceset e impiantit te fraksionimit. I gjithë procesi është i automatizuar.

Lendet e para qe futen ne poces:

Lendet e para qe futen ne impiantit e fraksionimit dhe prodhimit te profdukteve abrasive ndahen si me poshte:

1. Minerale jo metalike (guri gëlqeror, konglomerat, etj);
2. Materiale inerte;
3. Mbetje inerte jo te rrezikshme, te pershtatshme per prodhimin e produkteve abrasive;
 - 01 01 01 - Mbetje që dalin nga nxjerrja e mineraleve metalore (*sterilet/mineralet jometalore*)
 - 01 01 02 - Mbetje që dalin nga nxjerrja e mineraleve jometalore (*sterilet*)
 - 01 03 06 - Sterile të tjera nga ato të përmendura në 01 03 04 dhe 01 03 05
 - 01 03 99 - Mbetje të tjera të paspecifikuara (*mbetje inerte te pershtatshme per prodhimin e produkteve abrasive*)
 - 01 04 08 - Mbetje zhavorri dhe mbetje gurësh të tjera nga ato të përmendura në 01 04 07
 - 01 04 09 - Mbetje rërash dhe argjilash
 - 01 04 12 - Sterile dhe mbetje të tjera që vijnë nga larja dhe pastrimi i mineraleve, të tjera nga ato të përmendura në 01 04 07 dhe 01 04 11
 - 01 04 13 - Mbetje që vijnë nga prerja dhe sharrimi i gurëve, të tjera nga ato të përmendura në 01 04 07
 - 01 04 99 - Mbetje të tjera të paspecifikuara (*mbetje inerte te pershtatshme per prodhimin e produkteve abrasive*)
 - 17 01 01 - Beton
 - 17 01 02 - Tulla
 - 17 01 03 - Tjegulla dhe qeramika
 - 17 01 07 - Përzierje të betonit, tullave, tjegullave dhe qeramikës, të tjera nga ato të përmendura në 17 01 06
 - 17 05 04 - Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03
 - 17 05 08 - Çakëll, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 07
 - 17 08 02 - Materiale ndërtimi me gips, të tjera nga ato të përmendura në 17 08 01
 - 17 09 04 - Mbetje të përzierja nga ndërtimi dhe të prishjeve, të tjera nga ato të përmendura në 17 09 01, 17 09 02 dhe 17 09 03
 - 19 12 09 - Mineralet (p.sh. rërë, gurë)
 - 19 13 02 - Mbetjet e ngurta nga rehabilitimi i tokës, të tjera nga ato të përmendura në 19 13 01
 - 20 02 02 - Dhera dhe gurë

Persa i perket mbetjeve te listuara me siper perpara se te futen ne procesin e fraksionimit me qellim rikuperimin e tyre per prodhimin e materialeve abrazive/inerte behet nje vleresim nese jane te pershtatshme apo jo. Ne rast se mbetja nuk eshte e pershtatshme atehere do te transportohet nga

subjekte te licensuara per menaxhimin e tyre drejt operatoreve te trete gjithashtu te licensuar per asgjesimin final te tyre.

Procesi i rikuperimit te mbetjeve inerte / sterileve jometalore etj eshte i njetje me procesin qe i nenshtrohen mineralat jometalore per prodhimin e materilaeve abrazive te cilat do te perdoren per prodhimin e produkteve abrazive.

Pershkrim i pergjithshem


Impianti i fraksionimit te lendeve te para per prodhimin te produkteve abrazive apo materileve inerte me destinbacion industrine e ndertimit funksionon mbi bazen e nje procesi te thjeshte fizik, i cili ben te mundur qe lenda e pare inerte, qe ka permasa te kokrrizave te medha, i nenshtrohet proceseve fizike si thyerja dhe bluarja, duke perftuar ne kete menyre produktin e deshiruar per industrine e ndertimit apo per impiantin e prodhimit te betonit dhe asfaltbetonit te vete kompanise.

Hapat qe ndiqen ne impiantin e fraksionimit te inerteve jane:

Pedane e Furnizimit → Bunker Ushqyes → Mulliri primar → Site Vibruese → Mulliri Konik → Mulliri centrifugal → Site Vibruese → Transportier te produktit final → Pulti i Komandimit

Nga ky nuk gjenerohen mbetje, pasi i gjithe minerali i thyer fraksionohet sipas madhesise se grimces.

Bashkengjitur gjeni karten teknologjike te impiantit.



impaintit te prodhimit te produkteve abrazive



3.5 Impianti i prodhimit te betonit


Elementet kryesore te impiantit te betonit.

- Bunkeri I magazinimit te agregateve
- Bunkeri I peshimit te agregatit
- Rripi I transportuesit nxjertes
- Rripi transportues
- Kabina e kontrollit
- Bunkeri I mbajtjes se agregateve
- Bunkeri I mbajtjes se cimentos
- Bunkeri I peshimit te ujit
- Transportues me vidë të çimentos
- Sillos I magazinimit te cimentos
- Struktura mbajttese e sillosit
- Mishelatori
- Koni I shkarkimit
- Përzierësi i binjakëzuar

Sekuena e operacioneve për një cikël prodhimi eshte :

- Kontrollohet që njësia e ujit të jetë nën presion.
- Fuqizimi i panelit elektrik dhe aktivizimi i qarkut të kontrollit.
- Komisionimi i kompresorit (impiantit përzierës) dhe pritje që të gjitha qarqet pneumatike të jenë nën presion.
- Doza e inerteve.
- Dozimin e çimentos.
- Futja 10-15% të ujit në mikserin e kamionit.
- Shkarkimi i agregateve në mikserin e kamionit.
- Shkarkimi i betonit në përzierësin e çimentos.
- Mbyllni dozimin e ujit.





Prodhimi i Betonit

Betoni është një masë e përbërë nga material inertë të thata (rërë, granit) dhe nga cimento aditive të ndryshme që ndihmojnë procesin e tharjes e të ngrirjes së betonit .

Kjo përberje është një material natyror dhe i riciklueshëm dhe është i përdorshëm në një gamë të gjërë në fushën e ndërtimit, mund të përdoret në bordurat e rrugëve, pistave të ndryshme, shesheve dhe fushave sportive, vepra arti të ndryshme si ura, mbikalime dhe nenkalime, kolona mbajtëse, ndertesa banimi dhe shërbimi etj.

Materialët inertë që do të përdoren për prodhimin e betonit sipas klasave të ndryshme janë të cilësive së lartë dhe konform kushteve të cilësive për këto produkte. Inerti që përdoret është i lartë dhe sigurohet nga impianti i prodhimit të produkteve abrasive, produkte të cilat janë në funksion të prodhimit të betonit.

Për prodhimin e 1 m³ betoni nevojiten 1.3 m³ inertë (në raport 50% rërë e lartë dhe 50% inertë të fraksioneve të ndryshme), nevojitet 250-400 kg cimento (masa e cimentos është në varesi të markes së betonit që kërkohet të prodhohet), si dhe ujë në sasi dhe varesi të përdorimit të betonit, pasi për

kollonat, themelet, soletat masa e betonit kerkohet e ndryshme ne aspektin e holle, mesatare apo mase me e thate, ndersa aditiv sipas rastit dhe nevojës se perdorimit (ne varesi te temperaturave nen zero grade).

Nepermjet programimit kompjuterik duke percaktuar marken e betonit, sasine e nevojshme te prodhimit e cila realizon vete hedhjen e lendes se pare, perzjerjen dhe ne menyre automatike realizohet prodhimi i betonit. Direkt nga fabrika nepermjet transportiereve ne forme shneku hermetik, betoni i pergatitur hidhet ne autobetoniere.

Koshat agregatë të depozitimit, të ndarë në pjesë, me porta ngarkimi me operim elektro pneumatik, me vibrator elektrik në pjesën e rërës për të lejuar rrjedhje më të mirë të materialit. Hapja për ngarkim me anë të ngarkuesit të çdo pjese është 3,15 m. Muret anësore janë të palosshëm për transportim dhe montim të lehtë.

Linja e prodhimit te betonit eshte teknologji e standarteve europiane.

Linja e procesit teknologjike eshte e perbere nga bunkeri per materialet inerte i ndare ne bokse te ndryshme. Materiali i depozituar ne nje piste e cila eshte e shtryar me beton hidhet ne bokate me mjetet fadrome ne dimensione te ndryshme rere 0-2 mm, granil 2-6 mm, granil 6-10 mm dhe granil 10-26 mm (lenda e pare sigurohet nga karriera me te cilin subjekti ka kontrate furnizime dhe impianti i prodhimit te produkteve abrazive ne pronesi te shoqerise). Bokset kane nje kapacitet depozitues prej 40 m³, procesi teknologjik vazhdon me peshimin e materialit inert per realizimin e markes se kerkuar te betonit. Ne te njejten kohe qe peshohet material i inert ne pershore, ne peshoren tjeter peshohet cemento e cila vjen nga silloset e cimentos. Linja ka 1 sillos me kapacitet 60 ton. Sillosi eshte i mbyllur ne menyre hermetike. Furnizimi behet me tuba gome me diameter 150 mm. Ne linje eshte instaluar filtri i pluhurave te cimentos ne menyre qe pluhuri te mos dale ne atmosfere.

Pas peshimit ne peshore e cimentos me anen e nje shneku te hermetizuar cemento kalon ne voting e autobetonjeres e cila eshte me xhiro maksimale 16 xhiro/min. Me ane te ketij procesi pergatitet bojaku uje + cemento. Uji hidhet nga rezervuari me linja te rregullta me komandim nga pulti i komandimit te impiantit, ku matet sasia e ujit.


Pas pergatitjes se bojakut me xhiro maksimale te botit te autobetonjeres hidhet material i inert me komandim nga pulti i komandimit te linjes. Ne kete linje te prodhimit te betonit ka nje ajrim i cili sherben per hapjen dhe mbylljen e bokaportave te bokseve te peshores se inertit, per shtyrjen e cimentos nga sillosat dhe peshorja e cimentos, si dhe linja e ajrit e cila sherben per filtrin e ajrit te cimentos.

Subjekti disponon autobetonjere dhe pompe betoni me bige 36-38 m. Per transportin e inerteve disponohen disa makineri veteshkarkuese ku 3 prej tyre sherbejne kesaj njeje betonit. Te gjitha mjetet kontrollohen per kushtet teknike te tyre dhe qe nuk kane rrjedhje te materialit. Ne pisten e depozitimit te materialit eshte instaluar nje linje sperkatje uji per te shmangur ngritjen e pluhurit gjate levizjes se mjeteve.

Lloji i impiantit eshte i tille qe komandohet nepermjet njesise qendore, ku behet edhe programimi i sasise se lendeve te para qe do te marri ne perqindje te caktuar, per prodhimin e betonit. Impjanti eshte i lidhur me depoziten e ujit, me depoziten e solventeve, reren e cila merret ne menyre automatike nepermjet hinkave ku qendron lenda e pare dhe hidhet ne kazanin e perzjerjes.

SKEMA TEKNOLOGJIKE PRODHIMIT TE BETONIT

KAPACITETI: 80 m³/ORË



Skema teknologjike e prodhimit te betonit

Impianti i prodhimit te asfaltobetonit

Impianti i prodhimit te asfaltit, ka destinacion kryesor prodhimin e konglomerateve bituminoze per nevojat e shoqerise per shtrimin e rrugeve.

Konglomeratet bituminoze jane perzierje e agregateve inerte (rere, granile dhe mbushes) ne te nxehte me bitum qe sherben si lidhes dhe qe perdoren per asfaltimin e rrugeve etj.

Konglomeratet bituminoze kane ngjyre te zeze, me arome karakteristike dhe gjendje fizike viskoze. Temperature e nxehtes ne furre e perzierjes se inerteve arrin 1800 c.

Gjithashtu prodhohen konglomerate bituminoze te ftohta te cilat kane perdorim te madh ne mirembajtjen e rrugeve, riparimin e demtimit te asfalteve te rrugeve ekzistuese.

Asfalti pasi vendoset ne objekt me pajisjet dhe makinerite perkatese, nga mase vizkoze gradualisht duke u ftohur ngurtesohet dhe ruan aftesine elastike.

Raportet e lendeve perberese dhe granulometria e agregateve perberes dhe bitumit, realizohen mbi bazen e recepturave te percaktuar nga drejtuesi teknik, per cilesi te ndryshme elasticiteti dhe kompaktesie.

Ne raste te vecanta per prodhime asfalto-betoni me kerkesa specifike, karakteristika te rritura, perdoren per pergatitjen e tij, shtesa te ndryshme, si ngjyrues, material plastik, cemento etj.

Inertet, si rera, granili "1", granili "2", etj, hidhen me fadrome ne bunkerin e pranimit ne ndarjet perkatese.

Sitat

Sitat sherbejne per ndarjen e materialit sipas madhesis se grimcave, per te respektuar recepturen e projektuar te asfalto-betonit.

Meqenese inertet e hedhura ne prodhim, jane dozuar me pare, sistemi i sitave, ka funksion te nxjerre ne menyre automatike, nepermjet nje sistemi te caktuar, materialin inert me grimca me diameter me te madh, se percaktimi ne receten e prodhimit.

Sistemi i shkarkimit te seciles site nepermjet nje sistem tubash nxjerr nga linja materialin qe nuk kalon ne site.

Poshte sitave jane te vendosur depozitat e asfalto-betonit, ne te cilat depozitohet prodhimi, gjate kohes qe daljet e sitave per ne peshore jane te mbyllura.

Peshorja

Peshimi i inerteve sipas nje radhe te caktuar kryhet per secilin material. Peshorja nepermjet nje sistemi te caktuar automatik sipas komandes se dhene, kryen ngarkimin e nje fraksioni ne trasportier dhe pasi arrin sasine e caktuar ngarkon ne trasportier materialet e tjera ne menyre te njepasnjeshme.

Gjate kohes se peshimit te inerteve ne linje te vecante me peshore te vecante, peshohet dhe sasia e bitumit qe futet ne procesin e prodhimit te asfaltobetonit. Pas peshimit materialet inerte dhe bitumi hidhen ne perzieres.

Perzieresi

Perzieresi është pajisje metalike në formë kazani me një sistem lopatash, të cilat shërbejnë për perzierjen e inerteve të thata me bitumin.

Në perzieres bitumi i lëngshëm dhe i tejnxehur bashkohet me inertet, penetron në porët dhe çarjet e grimcave dhe i mbulon ato me një cipë të hollë me trashësi që është në funksion të vizkozitetit të lidhësit.

Sasia e bitumit në perzieres sipas recepturës së përcaktuar bëhet në momentin e hedhjes së inerteve. Në perzieres inertet e thata me bitumin e lëngshëm të tejnxehur perzihen dhe mbahen mbi 20 sekonda. Pas kësaj agregati i prodhuar dërgohet në një kove të cila e shkarkon tashmë asfaltobeton në silloset e grumbullimit si produkt të gatshëm për asfalt.

Tharja dhe ngrohja

Inertet me transportier dërgohen në furren cilindrike rrotulluese.

Në pjesën fundore furra është pajisur me një sistem sprucimi të lëndës djegëse, ndezja e sprucatorit bëhet automatikisht dhe temperatura mbahet në parametrat teknik me anë të termocifteve .

Në furren e tharjes flaka nuk bie në kontakt me materialin që hidhet në të. Inertet në furren e tharjes (meqenëse ajo është e pjerret të ndihmuar dhe nga disa shnek të vendosur në trupin e cilindrit të furrës) avancojnë gjatë rrotullimit drejt zonave me të nxehta dhe thahen. Temperatura e tymrave në dalje të furrës është me e vogël se ajo e agregatit dhe luhetet në kufijtë 120 –1500 °C.

Ngrohja e agregateve

Pjesë përberëse e impiantit të prodhimit të asfaltit është kaldaja.

Kaldaja punon me lëndë djegëse gaz dhe ngroh të gjithë agregatet që përdoren për prodhimin e asfaltit të përmendur më lartë si inertet në furren e tharjes, duke përfshirë dhe agregatet e tjera, Ngrohja e bitumit në cisternë dhe tubacionet e transportit bëhet me transmetim nxehtësie me serpentina vaji.

Silloset

Në silloset e grumbullimit materiali (asfalti i prodhuar) mbahet në një temperaturë rreth 1400 °C. nga një sistem ngrohjeje. Ky sistem është një bashkësi tubacionesh tip radiator që duke u nxehur nga kaldaja bëjnë qarkullimin e vajit të nxehur. Tubot janë të vendosur për gjatë faqes anësore të sillosit në formë spirale.

Serbatoret e bitumit

Bitumi në kushte natyrore, në temperaturën e ambientit është pak i rrjedhshëm dhe vizkoze. Për të ulur vizkozitetin dhe për të rritur rrjedhshmërinë, ai nxehet në temperaturë deri 1800 °C . Ngrohja e bitumit deri në temperaturën e përcaktuar më lartë bëhet nga një sistem radiatorësh me vaj të tejnxehur nga një kaldaje që përdor për djegie lëndë djegëse. Vaji i tejnxehur në kaldaje qarkullon në sistemin e tubacioneve të vendosur në serbatorin e bitumit dhe e ngroh atë në temperaturën që kërkohet.

Lenda djegese perdoret ne kaldajen e ngrohjes se bitumit dhe furren e cilindrike te rrotullushme per tharjen e inerteve.

Automatizimi

Impianti i prodhimit te asfalteve eshte prodhim relativisht i ri, me teknologji te perparuar dhe e automatizuar.


Kujdes i vecant eshte kushtuar gjate lidhjes se kontrates per aparaturat e dozimit te lendes se pare, lendes djegese, mbajtjen e temperatures ne parametrat teknik, kapjes se tymrave, pluhurave dhe trajtimit te tyre.

Impianti eshte pajisur me sistem mbrojtës dhe alarmi qe nderhyjne per te modifikuar ose ndaluar impjantin kur vlerat qe tregojne aparatet largohen nga vlerat e lejuara.


Sistemi i ajrimit

Sistemi i ajrimit fut ajer me presion te rritur nga jasht ne furren e nxehjes se inerteve per te ndihmuar djegien, sherben njekoheisht edhe per nxjerrjen e gazeve te prodhuara nga djegia. Gazrat e prodhuar nga djegia para se te dalin ne oxhakun e fures kalojne ne dhomen e filtrimit te gazeve dhe pluhurit. Keshtu ajo eleminon te gjitha tymrat vajore, ndotese te krijuara nga djegia (metan+propan), kap pluhurat e imta te inerteve dhe i rikthen ato perseri ne ciklin e prodhimit te asfaltit.

Planimetri e linjës teknologjike



Procesi teknologjik i paraqitur ne menyre skematike si me poshte:



4 MASAT ZBUTESE TE NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Masat e pergjithshme te propozuara per zbutjen e ndikimeve negative mjedisore

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate procesit te thyerjes se gurit, si te pluhurit ne ajer, zhurmave, erozionet si dhe uljen e efekteve negative hapsinore ne territor, faun dhe flore.

Parandalim

- Perzgjedhja e teknologjise me cikël të mbyllur me pajtueshmeri mjedisore
- Instalimi korrekt i makinave, sipas skemes teknologjike te permiresuar
- Perzgjedhja dhe trajnim i personelit per menyren e perdorimit te teknologjise dhe veprimit
- Siperfaqja e kantierit do te jete vazhdimisht e lagur per shmangien e ngritjes se pluhurit gjate aktivitetit;
- Kontroll i vazhdueshem dhe mirmbajtje e filtrave te kapjes se pluhurit dhe gazeve
- Sigurimi i sistemit te komandimit te pompave, filtrave dhe pastruesve te tjere;
- Zbatim i rigoroz i sigurimit teknik gjate punes dhe nderprerjes se saj
- Vezhgim dhe kualidim i vazhdueshem i te gjithe teknologjise se projektit, sistem i qarrkullimit te produktit, saracineska, tubo, valvola, tapa, guarnicione;
- Testimi periodik i teknologjise agregateve te saj.

Kontroll

- Sigurimi i te gjitha pajisje te nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje ne rast emergjencash
- Kompaktesim dhe lagje e inerteve ne qiell te hapur
- Lagje e sheshit te punes dhe rrugeve te levizjes se kamioneve ne kantier
- Levizje e ngadalte e automjeteve ne kantier dhe jashte tij
- Larje e shpeshte e makinerive dhe kamioneve te punes
- Transporti i inerteve me kamion te mbuluar mbulesa me Polietilieni
- Gjeneratori dhe pompa e karburantit duhet te rrethohet me mur dhe te kete nje vend te vecant

Nderhyrje

- Riparim i menjehershem i difekteve dhe avarive teknologjike
- Aktivizim i menjehershem i stafit dhe mjeteve ne rast emetimesh dhe derdhjesh te pa parashikuara sipas skemes. - Pastrim i menjehershem i derdhjeve aksidentale
- Njoftim i menjehershem i autoriteteve dhe njesive te specializuara ne rast emergjencash (zjarrfikes, autoambulanca)

Administrim

- Perdorimi dhe ruajtja me pergjegjesi i te gjithe infrastruktures dhe makinave sipas skemes dhe rregullave teknologjike.

Pluhura te shkaktuara gjate fazes se transportit (aerosole)

Mjetet e transportit duhet te levizin te mbuluara gjate transportit te ngarkeses, mjetet duhet te pastrohen vazhdimisht nga balta para daljes se tyre nga kantieri .

Emetim gazesh nga automjetet

Sasia do te jete minimale por duhet te punohet me eficence dhe te ulet koha e mbajtjes ndezur pa gene nevoja e motoreve te mjeteve.

Filtrimi i gazeve nga impianti I prodhimit te asfaltobetonit

Ne procesin e prodhimit te asfaltit clirohen tymra dhe avuj uji nga djegia e gazit qe perdoret per tharjen e inerteve dhe gjate nxehjes se bitumit.

Per te menjanuar efektet negativ ne mjedisin rrethues nga prezenca e tymrave, impiant eshte pajisur me sistemin e kapjes se tymrave me filtra. Sistemi filtrimit te tymrave eshte paisje e rendesishme per procesin teknologjik dhe per mbrojtjen e ambientit nga ndotja. Kjo paisje ka kosto te larte dhe e domosdoshme per kete teknologji te zbatuar.

Perdorimi i sistemit te kapjes se tymrave dhe pluhurave me sistemin e filtrave ul nivelin e tymrave, blozes dhe pluhurit ne nivelin e standarteve te Bashkimit Evropian.

Sasia e mbetjeve te kapura me filter rifutet automatikisht ne procesin teknologjik per te mos varferuar receten dhe mos demtuar cilesin e prodhimit te asfaltit.

Filtrimi i pluhurave krahas qe mbron ambientin nga ndotja eshte dhe nje domosdoshmeri teknologjike per te mos ndryshuar raportet e perberesve te perdorur per prodhimin e asfaltit.

Emetim zhurmash vibracioni dhe aromash

Duhet te kontrollohen vazhdimisht pajisjet dhe impiantet per zhurmen e shkaktuar. Edhe per kete ndikim duhet te shkurtohet ne maksimum koha e mbajtjes ndezur te motorave te mjeteve;

Menaxhimi i mbetjeve ngurta

Administrata dhe punonjesit do ti kushtojne vemendje te vecante edhe ketij aspekti per te parandaluar ndotjen ne mjedis nga dispersiteti i amabalazheve te cimentos etj. Ne mjediset e kantierit jane vendosur kazane te grumbullimit te mbetjeve te krijuara nga veprimtaria e kantierit. Mbetjet shoqeria do ti dergoje sipas nje marreveshje me njesine administrative te zones ne fjale ne pike grumbullimin e mbetjeve urbane te zones.

Menaxhimi i mbetjeve te lengta

Mbetjet e lengta jane ujrat qe shkarkohen nga larjet teknologjike te impiantit te betonit dhe autobetoniereve. Ujrat qe gjenerohen nga procesi I larjes se autobetoniereve apo impiantit te prodhimit

te betonit betonit, duke gene se kane permbajtje te larte te lendes se ngurt orientohen

per ne vasken e dekantimit. Fillimisht procesi I larjes se autobetonierve dhe impiantit te betonit kryhe tme qellim eleminimin e ngrirjes se betonit te mbetur ne perziersin e tyre I cili do te nxirte jasht funksionit autobetonieret apo vete impiantin e prodhimit.

Vaska e dekantimit sherben per te pritur ujjart lares te autobetoniereve dhe impiantit te prodhimit te betonit, duke eleminuar ne kete menyre shkakrimin e tyre ne trupat ujjore siperfaqesore.

Vaska e dekantimit sherben per te bere ndarjen e fazes se lenget (uji) dhe fazes se ngurt (rera e perzier me cakull/zhavor dhe cemento, aditive).

Pas procesit te dekantimit, uji I qartesur/pa permbajtje te lendes se ngurt riperdoret serisht ne procesin e prodhimit te betonit, ndersa pjesa e ngurt/llumi I betonit qendron ne vasken e dekantimit der ne nje moment kur arihet nje sasi e konsideruesheme (70% e thellesise se vaskes se dekantimit). Pas arritjes se kufirit te thellesise se vaskes se dekantimit (70% e thellesise se vaskes se dekantimit), e gjithë masa e ndodhur ne vasken e dekantimit rifutet serisht ne impiantin e prodhimit te betonit.

Riperdorimi I llumrave te betonit dhe ujjrave pas dekantimit behet per arsye se keto llumra kane te njeteten perberje sikurse edhe betoni vete (rere, zhavor/cakull, cemento, uji dhe aditive sipas rastit).

Programi i monitorimit dhe elementet e tij

Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet kane marre ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis. Persa me siper eshte menduar qe te perzgjidhen per tu monitoruar nga laboratore te nenkontraktuar nga vete shoqeria ata elemente qe realisht mund te indentifikohen, maten, rregjistrohen dhe komunikohen ne organet e administrimit te mjedisit (DRM, Bashki etj). Te dhenat cilesore, sipas tabelës do te hidhen ne nje regjister qe administrohet nga vet kompania dhe do te dorezohen ne DRM e Qarkut sa here ju kerkohet, sipas proceduarve ligjore dhe rregulloreve.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Zbatimi i projektit nuk do te kete pasoja negative te mundshme ne mjedisin e zones.

Procesi teknologjik i fraksionimit nuk shoqerohet me shkarkime të lëngta të rrezikshme. Ujjerat që përdoren në linjën e fraksionimit thuhet nuk kanë teprica sepse dozohen ne sasi te percaktuara, sasite minimale shkarkohen vetem pas dekanitimit te mases se ngurte ne vasken dekantuese.

Meqenëse lendet e para te përdorura për fraksionim jane gure gelqerore, ujjerat nuk kanë elemente qe mund të kontaminojnë mjedisin ujjor prites, sipërfaqësore, nentokësore apo tokën.

Perreth perimetrit te objektit do te ndertohen kanalet drenazhues per ujjerat atmosferike ne menyre qe te shmanget fenomeni i erozionit.

Ky aktivitet nuk perdore lende te rrezikshme per shendetin e punonjesve si dhe te popullsisë perreth zones dhe si rrjedhim nuk ndikon negativisht tek ata.

Ky projekt nuk sjell emetime te gazeve ne atmosfere .

Gjatë procesit të ngarkim – shkarkimit te materialit behet pluhur i lehte dhe drejtuesit

e shoqerise do te marrin masa per sperkatjen me uje, për paisjen e punëtoreve dhe manovratorve te mjeteve te renda me mjetet e domosdoshme për mbrojtjen nga pluhuri, si kominoshe pune, kapele mbrojtese, doreza pune, maska për mbrojtjen nga pluhuri.

Niveli i zhurmave qe vijne nga automjetet dhe pajisjet e tjera jane brenda normave te lejuara. Nuk perbejne problem shqetesues per punonjesit dhe as per banoret e zones perreth qe jane ne nje distance te konsiderueshme.

Furnizimi me uje do te sigurohet nga nje pus qe ndodhet ne ambjentet ku do te ngrihet impianti

Furnizimi me energji elektrike do te sigurohet nga rrjeti ekzistues qe mbulon zonen duke plotesuar te gjitha kushtet teknike.

Zona ku do zbatohet projekti nuk njihet si zone e mbrojtuar me vlera arkitektonike dhe kulturore , pra nuk kemi ndryshime apo demtime te saj duke qene se nuk ekziton ne kete territor.

Per nje pune sa me optimale në impiant zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe punetoret e manovratoret njihen me keto rregulla ne menyre periodike nga drejtuesit teknik te firmes.

Rekomandime

☒ Duke ditur se gjate proceseve te punes ne linje emetohen në mjedis pluhur i lehte, ka zhurma te makinerive për të rritur sigurinë në punë të punonjësve dhe per te ulur ne maksimum impaktin ne mjedis, duhet të:

☒ Te behet rregullisht monitorimi i gjendjes teknike te automjeteve

☒ Te behet monitorimi periodik i emetimit te zhurmave ne mjedis.

☒ Te behet monitorimi periodik i emetimit te pluhurit ne ajer.

☒ Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik,

☒ Te pastrohen dhe mirembahen kanalet e drenazimit te ujerave perreth perimetrit te

linjes

☒ Te menaxhohen mbetjet e ngurta ne bashkepunim me Njesine e Qeverisjes Vendore.

☒ Te sigurohet furnizim i mire me energji elektrike per te reduktuar ose shmangur oret e punes se gjeneratorit dhe nderprejre te procesit te punes.

☒ Te perdoret lende djegese e cilesise se pare per gjeneratorin dhe mjetet e transportit, ku niveli i sqfurit te jete brenda normes se lejuar prej 10ppm.

☒ Te aplikohet larja e shesheve te pa shtruara per te reduktuar pluhurin.

☒ Te mos depozitohet lende e pare ne sasi te medha, per te reduktuar demtimin e peizazhi dhe te erozionit te eres dhe te shiut.

☒ Te kryhet larja e automjeteve te transportit ne menyre periodike.

☒ Te vendosen kosha dhe postera sensibilizues per mbajtjen paster te ambjenteve